



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-30644/23
Kaçanik, 30.11.2023

Në bazë të nenit 12.2(d) lidhur me nenin 40.2 dhe 17 të Ligjit Nr. 03/L-040- Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28/2008 e datës 4 qershor 2008), të nenit 34.5 lidhur me nenin 6.2 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 30 nëntor 2023, mori këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E PROPOZIM VENDIMIT 01NR. 01 Nr. 104/02-30644/23 i DATËS 24.11.2023 PËR FALJEN E TATIMIT NË PRONË PËR VITIN TATIMOR 2023

1. Me këtë Vendim, REFUZOHET Propozim Vendimit i Kryetarit të Komunës 104/02-30644/23 i datës 24.11.2023 për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023, për të gjithë tatimpaguesit në lartësinë e tatimit në pronë deri njëqind (100) euro.
2. Refuzimi i Propozim Vendimit si në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet me arsyetim se miratimi i tij e zvogëlon në masë të madhe buxhetin e komunës së të Hyrave Vetanake Komunale të Komunës, pamundëson realizimin e projekteve kapitale që ndikojnë dukshëm në përmirësimin e jetës së qytetarëve.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Buxhetit dhe Financave.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtorja e Buxhetit dhe Financave;
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mursli

Makfire Malsiu

From: Vjosa Ahmetaj
Sent: Friday, December 15, 2023 2:32 PM
To: Kemajl Murseli
Cc: Besim Murtezani; Xhevat Tafa; Makfire Malsiu
Subject: Njoftim....

I nderuar,

Bazuar në Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, (shtojca II - Aktet e organeve të komunës që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm apo të rregullt të ligjshmërisë), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të Komunës së Kaçanikut, si në vijim:

- Vendimi 0 1Nr. 104/02-30644/23 për refuzimin e propozim Vendimit 01 Nr. 104/02-30644/23 i datës 24.11.2023 për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023, vendim i datës 30.11.2023, vlerëson se akti i komunës nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,
Vjosa Ahmetaj
Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave
Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave – MAPL
Tel: 038 200 64 144
E-mail: vjosa.ahmetaj@rks-gov.net
Adresa: Pallati i Shtypit Ish-Rilindja



01-Nr. 104/02-30644/23
24.11.2023

Komuna e Kaçanikut

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit NR. 08/L-224 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit NR. 06/L-005 PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME, Kapitulli II/A falja e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023, bazuar në Statutin e Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës së Kaçanikut, nxjerr këtë:

PROPOZIM VENDIM

- për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023

Neni 1 Pranueshmëria

Çdo tatimpagues që është i detyruar të paguajë tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2023 kualifikohet për faljen e tatimit të parashikuar me dispozitat e këtij kapitulli

Neni 2 Shuma e faljes së tatimit në pronë për pronën e paluajtshme

1. Shuma e faljes së tatimit në pronë për të gjithë tatimpaguesit lejohet deri në lartësinë e faturës së tatimit në pronë për vitin 2023, por jo më shumë se njëqind (100) euro në pajtim me dispozitat e këtij kapitulli.
2. Në rast se tatimpaguesi ka paguar faturën e tatimit në pronë për vitin 2023, shuma e falur i llogaritet si paradhënie për vitet pasuese.

Neni 3 Kufizimi

1. Falja tatimore e parashikuar me këtë kapitull zbatohet vetëm për vitin tatimor 2023 dhe nuk do të zbatohet për asnjë vit tjetër tatimor.

Neni 4 Zbatimi

1. Zbatimi i këtij kapitulli mbetet përgjegjësi e çdo komune përgjegjëse për administrimin e procesit të tatimit në pronë për pronat e paluajtshme që ndodhen brenda territorit të komunës.
2. Ministria përgjegjëse për financa nxjerr vendime që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e këtij kapitulli.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal.



Kryetari i Komunës
Besim Ilazi